REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 nëntor 2026
Nr. ref.:AGJ 3248/26

# AKTGJYKIM

në

**rastin nr. KI10/26**

Parashtrues

**Hysen Shala**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në lëndën [C. III. 12/0628] në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

## Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hysen Shala, nga fshati Rogovë, Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

## Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë akt konkret të autoriteteve publike, por konteston kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës me numër [C. III. 12/0628] në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme).

## Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [C. III. 12/0628] në Dhomën e Posaçme. Në lidhje me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për në proces të rregullt) dhe nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin mëtejmë: KEDNJ).

## Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

## Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 8 janar 2026, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën përmes Postës së Kosovës, derisa e njëjta u pranua më 13 janar 2026 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 19 janar 2026, Kryetari i Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI10/26] caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues, si dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI10/26] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Safet Hoxha dhe Bajram Ljatifi (anëtarë).

7. Më 4 shkurt 2026, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të (i) plotësojë formularin e kërkesës individuale dhe të specifikojë se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar; si dhe (ii) autorizimin specifik që dëshmon se përfaqëson [S.SH.], [H.SH.], [SH.H.], [N.H.] dhe [F.Q.].

8. Më 6 mars 2026, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi (i) formularin e kërkesës individuale në emër të parashtruesit të kërkesës; si dhe (ii) dokumentacion që ndërlidhet me procedurën gjyqësore, të cilën e konteston para Gjykatës.

9. Më 2 prill 2026, Gjykata, në mënyrë që të ketë pasqyrë të plotë të informatave lidhur me rastin, kërkoi informata nga Dhoma e Posaçme.

10. Më 21 prill 2026, Gjykata pranoi përgjigjet nga Dhoma e Posaçme.

11. Më 12 maj 2026, Gjykata kërkoi informata shtesë nga Dhoma e Posaçme.

12. Më 24 qershor 2026, pasi Gjykata nuk pranoi përgjigje nga Dhoma e Posaçme në pyetjet e parashtruara, kërkoi nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) që të përdorë autoritetin e tij për të siguruar që Gjykata Kushtetuese t'i ketë në dispozicion informacionet e nevojshme nga Dhoma e Posaçme.

13. Më 3 korrik 2026, Gjykata pranoi përgjigjet nga Dhoma e Posaçme.

14. Më 4 nëntor 2026, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri: (i) deklaroi kërkesën të pranueshme; (ii) konstatoi se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor; dhe (iii) urdhëroi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, që jo më larg se më 24 maj 2027, të informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës.

## Përmbledhja e fakteve

15. Më 6 prill 1994, [S.SH.], Hysen Shala dhe [H.SH.] paraqitën padi për vërtetim të pronësisë në Gjykatën Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale) kundër KB Rugova.

16. Më 12 dhjetor 1996, është caktuar seancë gjyqësore, e cila nuk është mbajtur.

17. Më 26 qershor 1997, është caktuar seancë tjetër, e cila është mbajtur.

18. Më 26 qershor 1997, Gjykata Komunale i është drejtuar Komunës së Gjakovës, respektivisht shërbimit kadastral me kërkesë për identifikimin e gjendjes faktike në terren për ngastrat lëndore me ekspert të gjeodezisë.

19. Më 16 maj 2003, paditësi [S.SH.] kërkoi me parashtresë që të vazhdohet procedura kontestimore.

20. Më 23 janar 2009, u caktua dhe u mbajt seanca gjyqësore, ku prezantoi avokati i paditësve, ndërsa për të padituri nuk prezantoi askush. Në këtë seancë u mor aktvendim procedural dhe nga Arkivi i Komunës së Gjakovës u kërkua procesverbali [nr.273] i 18 shkurtit 1949 të Këshillit Popullor në Rugovë.

21. Më 24 gusht 2009, avokati i paditësve dorëzoi një parashtresë, përmes së cilës i kërkoi gjykatës që të caktonte seancën kryesore në këtë çështje juridike.

22. Më 6 nëntor 2009, u mbajt seancë, në të cilën paditësi i tretë deklaroi se paditësi i parë [S.SH.] ka ndërruar jetë më 22 tetor 2009, dhe se paditësja [SH.H.] ka ndërruar jetë para dy (2) vjetësh, ndërkaq përkitazi me të ndjerët akoma nuk ishte shqyrtuar procedura e trashëgimisë. Në këto rrethana, Gjykata Komunale mori aktvendim përmes të cilit u ndërpre procedura në këtë rast derisa u përcaktua se *"Procedura e ndërprerë mund të vazhdoj pasi që të kryhet në formë të prerë procedura e trashigimisë ndaj tani të ndjerëve [....] me inciativën e ndonjërit nga palët në kontest, ose të trashigimtarëve eventual të të lartkërpemndurëve apo eventualisht kur G|jykata i fton pasardhësit juridik të të njejtëve që të e ndërmarrin procedurën në vend të tyre, në këtë qështje juridiko-civile"*.

23. Më 20 nëntor 2009, avokati i paditësve [S.SH.], Hysen Shala, [H.SH.], [SH.H.], [N.H.] dhe [F.G.], dorëzoi parashtresën për vazhdim të procedurës dhe përmes së njëjtës e njoftoi gjykatën lidhur me vdekjen e paditësit [S.SH.], dhe se si trashëgimtarë të tij janë: [B.SH.], [Z.M.], [I.O.], [I.SH.], [XH.SH.], [F.SH.], [D.SH.], [S.SH.], [A.SH.] dhe [P.SH.]. Përmes kësaj parashtrese, po ashtu gjykata u njoftua se si trashëgimtarë të [SH.SH.] janë [M.H.], [SH.H.] dhe [S.H.]. Pra, me këtë parashtresë u precizua kërkesa në pikëpamje subjektive për trashëgimtarët ligjorë të paditësit të ndjerë [S.SH.] dhe paditëses [SH.H], të cilët tash e tutje inkuadrohen si paditës të rinj, në vend të paraardhësve të *tyre*.

24. Më 21 prill 2011, u mbajt seanca gjyqësore me nxjerrje të provës për identifikim të pronës lëndore në vendshikim, në prani të ekspertëve të *gjeodezisë*.

25. Më 11 maj 2011, seanca nuk u mbajt pasi ekspertët e gjeodezisë nuk i dorëzuan Gjykatës Komunale ekspertizën lidhur me daljen në vend më 21 prill 2011, përkundër faktit se kanë qenë të obliguar ta dorëzojnë atë brenda afatit prej shtatë (7) ditësh. Në këtë kontekst, për avokatin e paditësve u bë e pamundur që të bëjë precizimin e kërkesëpadisë. Andaj, me propozim të të autorizuarve të ndërgjyqësve, seanca u shty për 21 korrik 2011.

26. Më 8 korrik 2011, ekspertët e gjeodezisë hartuan raportin me shkrim dhe skicën e matjeve lidhur me ngastrat lëndore.

27. Më 21 korrik 2011, u caktua seancë gjyqësore, e cila nuk u mbajt sipas kërkesës së avokatit të paditësve (përfshirë këtu parashtruesin e kërkesës), i cili e arsyetoi mungesën.

28. Më 8 dhjetor 2011, u caktua seancë gjyqësore, e cila nuk u mbajt sipas kërkesës së avokatit të paditësve, përfshirë këtu parashtruesin e kërkesës.

29. Më 11 janar 2012, sipas kërkesës së përfaqësuesit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), Zyra Regjionale në Pejë, u mor aktvendim procedural, me të cilin Gjykata Komunale u shpall jokompetente në pikëpamje lëndore dhe u konstatua se pasi ky aktvendim të marrë formën e prerë, shkresat e lëndës do t'i dërgohen Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, si gjykatë me kompetencë ekskluzive për procedim të mëtejmë.

30. Më 6 prill 2012, lënda kaloi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

31. Më 15 prill 2013, u lëshua urdhri [C-III-12-0628] për të padituri KB Rugova, AKP-së për t'u deklaruar në kërkesëpadi të paditësve.

32. Më 13 maj 2013, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj dorëzoi parashtresën në mbrojtje, përmes së cilës kundërshtoi kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetimin se paditësve u mungon legjitimiteti i plotë aktiv, pasi *"me prova nuk kanë dëgjuara se janë trashëgimtar ligjor të paraardhësve të tyre- nuk kanë prezantuar aktvendim për shqyrtim të trashëgimisë. Pastaj në kundërshtim është thirre edhe me faktin se paditësit nuk kanë dorëzuar asnjë provë të vetme, që vërtetojnë se kanë qenë pronar të ngastrave lëndore"*.

33. Më 16 maj 2014, Dhoma e Posaçme lëshoi urdhër dhe kërkoi nga avokati i paditësve të deklarohet në parashtresën e lartcekur të AKP-*së*.

34. Më 20 maj 2014, avokati i paditësve pranoi urdhrin dhe parashtresën e AKP-së, por nuk u deklarua përkitazi me të.

35. Më 11 mars 2020, rezulton se [A.SH.], [L.SH.] dhe [E.SH.] paraqitën kërkesa të veçanta secili prej tyre për blerje të aseteve - paluajtshmërive *"në formë Rregullores për shitjen e aseteve të caktuara të ndërmarrjeve shoqërore me negocim direkt"*.

36. Më 29 dhjetor 2025, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme lëshoi urdhër, për paditësit dhe të padituri, me qëllim të përgatitjes së seancës dëgjimore publike. Paditësve iu kërkua që në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh: (i) të plotësojnë padinë e tyre, duke saktësuar se kush janë palë paditëse dhe të dorëzojnë dëshmi të vdekjes/aktvendimin për shqyrtim të trashëgimisë; (ii) të dorëzojnë prova lidhur me vërtetimin e fakteve, të tregojnë bazën juridike në kërkesë pronësore dhe të precizojnë kërkesëpadinë; si dhe (iii) të plotësojnë ekspertizën gjeodezike, pasi është e mangët, sepse nuk është bërë krahasimi i numrave të kadastrit përshkrues me gjendjen në kohën kur është nxjerrë ekspertiza, si dhe historiati i pronës. Po ashtu, AKP-së iu kërkua që në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh të deklarohet në kërkesëpadi të paditësve, pasi përfaqësuesi i tyre në seancë gjyqësore ishte deklaruar vetëm lidhur me kompetencën *lëndore*.

37. Më 29 dhjetor 2025, urdhri iu dorëzua AKP-së.

38. Më 6 janar 2026, urdhri iu dorëzua avokatit të paditësve, përfshirë këtu parashtruesin e kërkesës.

*Përmbledhja e fakteve lidhur me veprimet e ndërmarra pas pranimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës në Gjykatë*

39. Më 12 janar 2026, rezulton se [A.SH.], [L.SH.] dhe [E.SH.] kanë paraqitur urgjencë përkitazi me kërkesat e veçanta të secilit prej tyre për blerje të aseteve - paluajtshmërive *"në formë Rregullores për shitjen e aseteve të caktuara të ndërmarrjeve shoqërore me negocim direkt"*. Në këtë shkresë theksohet se *"Javën e kaluar palët e lartcekura kanë shkuar në Zyrën e AKP në Pejë dhe atje iu është thënë se kërkesat e cituara nga Zyra Rajonal në Pejë iu janë përcjelle në Zyrën qendrore në Prishtin ënë vendosje. Tash, pas gadi gjashtë viteve paraqitet kjo urgjencë që kërkesaqt e të personave të përmendur të vendosen nga Bordi i AKP [...]"*.

40. Më 23 janar 2026, avokati i paditësve [H.SH.] , Hysen Shala, [N.H.], [F.G.], [B.SH.], [Z.M.], [I.O.], [I.SH.], [XH.SH.], [F.SH.], [D.SH.], [S.SH.], [A.SH.], [P.SH.], [M.H.], [SH.H.] dhe [S.H.], dorëzoi parashtresën, në të cilën bëri të ditur se në ndërkohë është informuar se kanë vdekur paditësit [B.SH.] dhe [SH.H.]. Me parashtresë, ai dorëzoi edhe (i) certifikatën e lëshuar nga Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi të Komunës së Gjakovës; (ii) certifikatën e vdekjes për [B.SH]; dhe (iii) certifikatën e vdekjes për [SH.H.]. Po ashtu, në parashtresë theksohet se *"Trashëgimia e paditësve të lartcekur tash të ndjerë, nuk është shqyrtuar. Do të bëjë përpjekje të sigurohet aktvendimi trashëgimor, edhe pse që në këtë afat është gadi e pa mundshme. [...] di të bëjë përpjekje që të siguroj të dhënat për trashëgimtar të të ndjerës [B.] në mënyrë që të i emërtoj si paditës pasardhësit e të ndjerës [B.], pasi duhet se janë jashtë vendit. Nëse nuk do të mundë të siguroj së paku dëshminë vdekjes, Gjykata i propozoj që të nderprehet procedura deri sa të zgjidhjet cështja paraprake, nga se me vdekjes e palës ka "vdekë" edhe autorizimi"*.

41. Më 26 janar 2026, Dhoma e Posaçme lëshoi urdhër për AKP-në për t'u deklaruar në parashtresën e lartcekur dhe provat e dorëzuara.

42. Më 28 janar 2026, AKP-ja dorëzoi parashtresën e përgjigjes, me të cilën ka kundërshtuar kërkesëpadinë dhe bashkëngjiti (i) kopjen e kërkesës së paditësve për

negocim direkt të kërkesës pronësore të ushtruar në vitin 2020; dhe (ii) kopjen e ekspertizës së ekspertit [XH.T], me raport me shkrim dhe kopje të planit.

43. Më 10 prill 2026, Dhoma e Posaçme mori aktvendim, përmes të cilit (i) u ndërpre procedura gjyqësore në këtë çështje juridike, për shkak të vdekjes së paditësve [B.SH.] dhe [SH.H.]; dhe (ii) u përcaktua se vazhdimi i procedurës do të bëhet pas shqyrtimit të trashëgimisë të të ndjerëve, me kërkesë të trashëgimtarëve ligjorë.

**Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

44. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [C. III. 12/0628] në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke pretenduar shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe nenit 6 (E drejta për në proces të rregullt) të KEDNJ-së. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

45. Në pretendimin e tij përkitazi me kohëzgjatjen e procedurës, parashtruesi i kërkesës thekson se rasti ka të bëjë me një padi për vërtetim të së drejtës së pronësisë, i cili është rast klasik civil dhe *"nuk kemi të bëjmë me hetime penale komplekese, ekspertiza të shumta ndërkombëtare apo çështje me volum të jashtëzakonshëm provash që do të justifikonin një procedurë mbi 30 vjeçare"*.

46. Parashtruesi i kërkesës specifikon se padia është paraqitur në vitin 1994 dhe se, pas vdekjes së paditësit, trashëgimtarët kanë vepruar menjëherë, më 26 nëntor 2009, për vazhdimin e procedurës. Tutje, thekson se *"Nuk ka asnjë indikacion se pala ka kontribuar në zvarritjen e çështjes. Lënda ka kaluar nga në numër në tjetrin. Ka pasur periudha të gjata pa vendim. Është shpallur jokompetencë pas afro 18 viteve procedurë. Që nga viti 2012, në Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës nuk është marrë vendim meritor. Kjo përbën vonese strukturore dhe institucionale për të cilën pala nuk mund të mbajë* përgjegjësi*"*.

47. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se, në total, procedura ka zgjatur mbi 30 (tridhjetë) vjet nga data e paraqitjes së padisë në vitin 1994, dhe akoma nuk ka një epilog gjyqësor. Po ashtu, ai specifikon se *"Gjatë gjithë kësaj kohe, trashëgimtarët e paditësve kanë mbetur në pasiguri juridike, e drejta e pronës nuk është konfirmuar apo refuzuar me vendim përfundimtar dhe prona ka mbetur në një gjendje pezull juridik. [...] Është tërësisht e pa shpjegueshme se si nuk është zgjidhë një lëndë e filluar në vitin 1994. Transferimi i kompetencës ka ndodhur pas afro 18 viteve procedurë. [...]"*.

48. Sipas parashtruesit të kërkesës, çështja e tij ka të bëjë me pronën, e cila është një e drejtë themelore me peshë të lartë ekonomike dhe ekzistenciale dhe *"Sa më e madhe rëndësia e çështjes, aq më i shkurtër duhet të jetë afati i procedurës. Procedura ka zgjatur mbi 30 vite. Një kohëzgjatje e tillë nuk përbën vetëm "vonesë", por përbën mohim të drejtësisë (denial of justice)"*.

49. Në vazhdën e pretendimeve, parashtruesi i kërkesës thekson se edhe pse nuk ka konfiskim formal, mosmarrja e një vendimi përfundimtar për mbi 30 (tridhjetë) vjet përbën ndërhyrje indirekte në gëzimin paqësor të pronës, cenim të sigurisë juridike dhe kufizim faktik të disponimit me pronën. Tutje, specifikon se *"Pronësia nuk është vetëm titull formal, por përfshin të drejtën për ta përdorur, disponuar dhe zhvilluar pronën. Pa një vendim gjyqësor, këto të drejta mbeten pezull. Në rastin konkret, vonesa nuk ndjek ndonjë qëllim legjitim publik. Ajo është rezultat i mosveprimit institucional. Për*

*rrjedhojë, ndërhyrja është joproporcionale dhe në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së".*

50. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës shton: *"Kërkoj që Gjykata Kushtetuese të gjykoj kompensimin e dëmit jo material për shkak të dhimbjeve shpirtërore si pasoj e shkeljeve të drejtave elementare njerëzore dhe kërkoj kompensimin e shumës prej 10.000,00 euro. Këtë e kërkoj nga Gjykata Kushtetuese pasi që vendi ynë ende nuk ka nxjerr Ligj për Mbrojtje të të Drejtave për shkak të shkeljes së të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm".*

***Përgjigjet e Dhomës së Posaçme në pyetjet e Gjykatës***

51. Më 2 prill 2026, Gjykata Kushtetuese, në mënyrë që të kishte një pasqyrë të plotë të rastit, i kërkoi Dhomës së Posaçme që të ofronte informata konkrete dhe të qarta për çështjet si në vijim:

*"Kërkohet nga ana Juaj të na ofroni informata rreth historikut, fakteve dhe kronologjisë së trajtimit të këtij rasti nga Dhoma e Posaçme;*
*Kërkohet të njoftoni Gjykatën, në cilën fazë të procedurës është aktualisht rasti në fjalë pranë Dhomës së Posaçme;*
*Luteni të njoftoni Gjykatën Kushtetuese përkitazi me rrethanat, të cilat kanë ndikuar në mostrajtimin e këtij rasti që nga viti 2012;*
*Nëse ekzistojnë rrethana që e kanë pamundësuar Dhomën e Posaçme të procedojë në shqyrtimin e rastit në mënyrë meritore, luteni t'i specifikoni të njëjtat dhe të sqaroni në bazë të ligjit të aplikueshëm pse të njëjtat janë me ndikim në mostrajtimin e lëndës;*
*Nëse ekzistojnë rrethana që kanë ndikuar në mostrajtimin e lëndës, cilët janë hapat e ndërmarrë nga ana Juaj për mënjanimin e tyre; si dhe*
*Çdo informatë tjetër që e konsideroni të dobishme përkitazi me rastin në fjalë".*

52. Më 21 prill 2026, Gjykata pranoi një shkresë nga Dhoma e Posaçme, në të cilën theksohet se: *"Me këtë parashtrese, si përgjigje në lidhje me rastin, por ua dërgojmë aktvendimin e DHPGJS, C-III-12-0628, dt. 10 prill 2026, me të cilin është ndërprerë procedura gjyqësore për shkak të vdekjes së palës. Në aktvendim janë përfshirë të gjitha të dhënat që i keni kërkuar si kronologjia e cështjes prej momentin kur është dorëzuar padia e paditësve më dt.06.04.1994, deri në marrje të aktvendimit dt.10.04.2026".* Aktvendimin e përmendur ia ka bashkëlidhur Gjykatës, ku përfshihet rrjedha procedurale e rastit, e cila është reflektuar më sipër në këtë Aktgjykim te pjesa e fakteve.

53. Më 12 maj 2026, Gjykata kërkoi informata shtesë nga Dhoma e Posaçme. Kjo pasi Gjykata vuri re se shumë pyetjeve specifike, të cilat nuk ndërlidhen me kronologjinë historike të rastit të parashtruara nga ana e Gjykatës në kërkesën për informata shtesë të datës 2 prill 2026, nuk u ishin dhënë përgjigje. Po ashtu, nga të dhënat e përfshira në Aktvendimin e dorëzuar rrjedhin informata të reja, për të cilat Gjykata kishte nevojë për sqarime. Andaj, në mënyrë që të kishte pasqyrë të plotë të fakteve të rastit, Gjykata kërkoi informata konkrete dhe të qarta, në çështjet si në vijim:

*"Përkitazi me paragrafin e përfshirë në Aktvendimin e 10 prillit 2026 "Më dt.29.12.20025, DHPGJS, ka lëshuar urdhër CC-II-12-0628, për paditësit dhe të padituri, me qellim të përgatitjes se seancës dëgjimore publike" – Gjykata vëren se mund të bëhet fjalë për vitin 2025, por luteni që të sqaroni se për cilin vit bëhet fjalë?;*
*Po ashtu, luteni të sqaroni cila është arsyeja që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për një rast që e ka pranuar në vitin 2012 ka lëshuar urdhër më 15 prill 2014 për të padituri që të deklarohet për kërkesëpadi të paditësve?;*

*Njëheri, kërkohet të sqarohet cila është arsyeja që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për një rast të pranuar në vitin 2014, ka lëshuar urdhër për përgatitje të seancës dëgjimore publike mbi një dekadë më pas?;*
*Luteni të njoftoni Gjykatën Kushtetuese përkitazi me rrethanat, të cilat kanë ndikuar në mostrajtimin e këtij rasti që nga viti 2012;*
*Nëse ekzistojnë rrethana që e kanë pamundësuar Dhomën e Posaçme të procedojë në shqyrtimin e rastit në mënyrë meritore, luteni t'i specifikoni të njëjtat dhe të sqaroni në bazë të ligjit të aplikueshëm pse të njëjtat janë me ndikim në mostrajtimin e lëndës;*
*Nëse ekzistojnë rrethana që kanë ndikuar në mostrajtimin e lëndës, cilët janë hapat e ndërmarrë nga ana Juaj për mënjanimin e tyre?; si dhe*
*Çdo informatë tjetër që e konsideroni të dobishme përkitazi me rastin në fjalë".*

54. Më 3 korrik 2026, Gjykata pranoi përgjigje nga Dhoma e Posaçme, e cila theksoi se: *"Në lidhje me cështjen e lëshimit të urdhrit, dt 29.12.2025, në faqen 3, paragrafi 4, ishe shënuar gabimisht 20225, nga vetë përmbajtja mund të kuptohet se është shënuar gabimisht një 0 më shumë, dhe se nga dispozitat e zbaqtuara në urdhër kanë të bëjnë me administirm të lendes dhe plotësim të parashtresave (padisë dhe përgjigjeve të dhëna) e që ka të bëjë me përgatitje të seancës dëgjimore dhe mundësia që palët, ti sqarojnë pretendimet e tyre dhe të bashkëngjisin prova, apo provat ti plotësojnë".*

55. Tutje, në përgjigjet e dhëna specifikohet se: *"Më dt. 23.01.2026, avokati Teki Bokshi, në emër të paditësve, dorëzoi parashtresën me kërkesë për ndërprerje të procedurës për shkak të vdekjes së palës, sepse vdekja e palës nënkupton edhe shuarje të autorizimit për përfaqësim për avokatin dhe domosdonë që trashëgimtaret ligjor të paditësit të shqyrtojnë trashëgimin, dhe të marrin përsipër procedurën gjyqësore me kërkesën e tyre".*

56. Po ashtu, në përgjigjet e dorëzuara në Gjykatë theksohet si në vijim:

*"Çështja që ka të bëjë lidhur me rastin para muajit tetor të vitit 2025, është se kjo lënde ka qenë te gjyqtari tjetër, por mos përgjigja e avokatit të paditësve, në urdhër të gjykatës për tu deklaruar në parashtresën e përgjigjes në padi nga AKP-ja, të cilin urdhër e kishte pranuar avokati me 20 04 2014 ndoshta ka ndikuar që me rastin të mos veprohet, pasi si prioritet të rasteve kanë qenë kërkesat e punëtorëve të natyrave të ndryshme, ndaj NSH-ve.*

*Mirëpo nga parashtresa e AKP-së, dt 28.01.2025 që me të është bashkëngjitur prova e dorëzuar kërkesa e palës [A.SH] për negocim direkt, e ushtruar në AKP në vitin 2020, ndoshta ka ndikuar që palët paditëse të presin përgjigjen e AKP-së për negocim.*

*Këtë kërkesë pala paditëse e ka heshtur para gjykatës me parashtresën 23.01.2026.*

*Pra në rastin konkret, avokati i paditësve nga momenti kur e ka pranuar Urdhrin për përgjigje në parashtresë të AKP-së, dt. 20.04.2014, dhe mos dorëzim të asnjë parashtrese, deri në momentin kur e ka pranuar urdhrin tjetër të dt. 29.12.2025, kur nga gjykata ju kanë kërkuar plotësimet e parashtresave me prova, mund të ketë ndikuar që kjo çështje të shqyrtohet më ngadalë, pastaj prioritetet e shqyrtimit të rasteve, pastaj përbërja e kolegjeve të përzir me gjyqtar të EULEX, dhe procedurat e përkthimeve të parashtresave dhe shkresave në gjuhën angleze të ketë pasur ndikim".*

**Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

**KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**Neni 31**
**[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

*"1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
*2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
*[...]".*

**KONVENTA EVROPIANE PER TE DREJTAT E NJERIUT**

**Neni 6**
**(E drejta për proces të rregullt)**

*"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm [...].*
*[...]".*

## Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

57. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

58. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

Nenit 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

*"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

59. Gjykata gjithashtu u referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të parashikuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa Individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që parashohin:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

*"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

*"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

Neni 49
(Afatet)

*"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]".*

60. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe se parashtruesi i kërkesës ka saktësuar kërkesën e tij ashtu siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit. Në lidhje me afatshmërinë e kërkesës, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston tejzgjatjen e procedurës përkitazi me lëndën [C. III. 12/0628] në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjykata, duke pasur parasysh natyrën e pretendimit, gjegjësisht tejzgjatjen e procedurës, rikujton se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kriterit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, përkatësisht kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit kohor prej 4 (katër) muajve.

61. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës, prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të shqyrtohen meritat e saj.

**Meritat**

62. Gjykata rikujton se rrethanat e rastit ndërlidhen me atë se më 6 prill 1994 [S.SH.], parashtruesi i kërkesës dhe [H.SH.] paraqitën padi për vërtetim të pronësisë në Gjykatën Komunale kundër KB Rugova. Gjatë periudhës që lënda ishte në shqyrtim në Gjykatën Komunale, u ndërmorën veprimet si në vijim: (i) më 12 dhjetor 1996, u caktua seancë gjyqësore, e cila nuk u mbajt; (ii) më 26 qershor 1997 u caktua seancë tjetër, e cila u mbajt; (iii) më 26 qershor 1997, Gjykata Komunale iu drejtua Komunës së Gjakovës me kërkesë për identifikimin e gjendjes faktike në terren për ngastrat lëndore me ekspert të gjeodezisë; (iv) më 16 maj 2003, paditësi [S.SH.] kërkoi me parashtresë që të vazhdohet procedura kontestimore; (v) më 23 janar 2009, u caktua dhe u mbajt seanca gjyqësore, ku prezantoi avokati i paditësve, përfshirë parashtruesin e kërkesës, ndërsa për të padituri askush. Në këtë seancë u mor aktvendim procedural dhe nga Arkivi i Komunës së Gjakovës u kërkua procesverbali [nr.273] i 18 shkurtit 1949 i Këshillit Popullor në Rugovë; (vi) më 24 gusht 2009, avokati i paditësve, përfshirë parashtruesin e kërkesës, dorëzoi një parashtresë, përmes së cilës i kërkoi gjykatës që të caktonte seancën kryesore në këtë çështje juridike; (vii) më 6 nëntor 2009, u mbajt seancë, në të cilën u deklarua se paditësi i parë [S.SH.] ka ndërruar jetë më 22 tetor 2009, si dhe paditësja [SH.H.] ka ndërruar jetë para dy (2) vjetësh, ndërkaq përkitazi me të ndjerët akoma nuk është shqyrtuar procedura e trashëgimisë. Në këto rrethana, Gjykata Komunale mori aktvendim përmes së cilit u ndërpre procedura në këtë rast; (viii) më 20 nëntor 2009, avokati i paditësve, përfshirë parashtruesin e kërkesës, dorëzoi parashtresën për vazhdim të procedurës dhe përmes së njëjtës e njoftoi gjykatën lidhur me vdekjen e paditësit [S.SH.] dhe për trashëgimtarët e [S.SH.] dhe [SH.SH.], duke plotësuar kështu kërkesën në pikëpamje subjektive për trashëgimtarët ligjorë të

paditësve të ndjerë; (ix) më 21 prill 2011, u mbajt seanca gjyqësore me nxjerrje të provës për identifikim të pronës lëndore në vendshikim, në prezencë të ekspertëve të gjeodezisë; (x) më 11 maj 2011, seanca nuk u mbajt, pasi ekspertët e gjeodezisë nuk i dorëzuan Gjykatës Komunale ekspertizën lidhur me daljen në vend; (xi) më 8 korrik 2011, ekspertët e gjeodezisë hartuan raportin me shkrim dhe skicën e matjeve lidhur me ngastrat lëndore; (xii) më 21 korrik 2011, u caktua seanca gjyqësore, e cila nuk u mbajt sipas kërkesës së avokatit të paditësve, përfshirë parashtruesin e kërkesës, i cili e arsyetoi mungesën; (xiiii) më 8 dhjetor 2011, u caktua seancë gjyqësore, e cila nuk u mbajt sipas kërkesës së avokatit të paditësve, përfshirë këtu edhe parashtruesin e kërkesës; (xiv) më 11 janar 2012, sipas kërkesës së përfaqësuesit të AKP - Zyra Regjionale në Pejë, ka marrë aktvendim procedural, me të cilin Gjykata Komunale është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore dhe u konstatua se pasi ky aktvendim të marrë formën e prerë, shkresat e lëndës do t'i dërgohen Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, si gjykatë me kompetencë ekskluzive për procedim të mëtejmë.

63. Tutje, kjo lëndë më 6 prill 2012 kaloi në Dhomën e Posaçme, në të cilën u ndërmorën veprimet si në vijim: (i) më 15 prill 2013 u lëshua urdhri [C-III-12-0628] për të padituri KB Rugova, AKP-së, për t'u deklaruar në kërkesëpadi të paditësve; (ii) më 13 maj 2013, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj e dorëzoi parashtresën në mbrojtje, përmes së cilës e kundërshtoi kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetimin se paditësve u mungon legjitimiteti i plotë aktiv; (iii) më 16 maj 2014, Dhoma e Posaçme lëshoi urdhër dhe kërkoi nga avokati i paditësve të deklarohet në parashtresën e lartcekur të AKP-së; (iv) më 20 maj 2014, avokati i paditësve pranoi urdhrin dhe parashtresën e AKP-së, por nuk u deklarua përkitazi me të; (v) më 11 mars 2020, rezulton se [A.SH.], [L.SH.] dhe [E.SH.] paraqitën kërkesa të veçanta secili prej tyre për blerje të aseteve - paluajtshmërive *"në formë Rregullores për shitjen e aseteve të caktuara të ndërmarrjeve shoqërore me negocim direkt"*; (vi) më 29 dhjetor 2025, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme lëshoi urdhër, për paditësit dhe të padituri, me qëllim të përgatitjes së seancës dëgjimore publike. Paditësve iu kërkua që në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh (a) ta plotësojnë padinë e tyre, duke saktësuar se kush janë palë paditëse, si dhe të dorëzojnë dëshmi të vdekjes/aktvendimin për shqyrtim të trashëgimisë; (b) të dorëzojnë prova lidhur me vërtetim e fakteve, të tregojnë bazën juridike në kërkesë pronësore dhe të precizojnë kërkesëpadinë; si dhe (c) të plotësojnë ekspertizën gjeodezike, pasi është e mangët. Po ashtu, AKP-së i është kërkuar që në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh të deklarohen në kërkesëpadi të paditësve, pasi përfaqësuesi i tyre në seancë gjyqësore ishte deklaruar vetëm lidhur me kompetencën lëndore; (vii) më 29 dhjetor 2025, urdhri iu dorëzua AKP-së; (viii) më 6 janar 2026, urdhri iu dorëzua avokatit të paditësve, përfshirë këtu edhe parashtruesin e kërkesës.

64. Gjykata vëren nga përgjigjet e Dhomës së Posaçme dhe të kronologjisë së paraqitur në Aktvendimin e datës 10 prill 2026 se (i) më 23 janar 2026, avokati i paditësve, përfshirë këtu edhe parashtruesin e kërkesës, dorëzoi parashtresën, në të cilën bëri të ditur se është informuar se në ndërkohë kanë vdekur paditësit [B.SH.] dhe [SH.H.], duke propozuar që të ndërpritet procedura derisa të zgjidhet çështja paraprake, e cila ndërlidhet me trashëgiminë e tanimë të ndjerëve; dhe (ii) më 10 prill 2026, Dhoma e Posaçme mori aktvendim, përmes të cilit u ndërpre procedura gjyqësore në këtë çështje juridike për shkak të vdekjes së paditësve [B.SH.] dhe [SH.H.] dhe u përcaktua se vazhdimi i procedurës do të bëhet pas shqyrtimit të trashëgimisë të të ndjerëve dhe me kërkesë të trashëgimtarëve ligjorë.

65. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se, si rezultat i kohëzgjatjes së paarsyeshme të procedurës gjyqësore, sipas kërkesëpadisë që ende nuk ka marrë zgjidhje përfundimtare, i është shkelur e drejta e tij për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Po

ashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

66. Gjykata në vazhdim do të trajtojë këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, në bazë të parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës së saj gjyqësore, por edhe asaj të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

**(I) Përkitazi me pretendimin lidhur me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore**

*Përcaktimi i kohëzgjatjes së procedurës*

67. Gjykata rikujton se, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, përllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih rastin e GJEDNJ-së: *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 50).

68. Në përllogaritjen e kohëzgjatjes së procedurës merret për bazë e gjithë procedura në tërësi, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit (shih rastin e GJEDNJ-së: *Konig kundër Gjermanisë*, nr. 6232/73, Aktgjykim i 28 qershorit 1978, paragrafi 98). Procesi gjyqësor konsiderohet i përfunduar në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga instanca e fundit gjyqësore (shih rastet e GJEDNJ-së: *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 74; dhe *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50).

69. Ekzekutimi i një vendimi gjyqësor konsiderohet pjesë integrale e gjithë procedurës dhe përfshihet në përllogaritjen e kohës së zgjatjes së asaj procedure (shih rastin e GJEDNJ-së: *Martins Moreira kundër Portugalisë*, nr. 11371/85, Aktgjykim i 26 tetorit 1988, paragrafi 44). Përllogaritja e kohëzgjatjes së procedurës nuk ndërpritet deri në momentin kur e drejta e fituar bëhet efektive (shih rastin e GJEDNJ-së: *Estima Jorge kundër Portugalisë*, nr. 24550/94, Aktgjykim i 21 prillit 1998, paragrafët 36-38).

***A. Parimet e përgjithshme të kohëzgjatjes së procedurës***

70. Gjykata rikujton se është detyrim i shtetit që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së: *Comingersoll kundër Portugalisë*, nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000, paragrafi 24; *Famullia Katolike Greke e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 142).

71. Gjykata rikujton se administrimi i drejtësisë pa vonesa është shumë i rëndësishëm për të mos rrezikuar efikasitetin dhe kredibilitetin e sistemit të drejtësisë (shih rastin e GJEDNJ-së: *Scordino kundër Italisë* (nr.1), nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006, paragrafët 224-225). Zgjatja e tepruar e administrimit të drejtësisë përbën një nga rreziqet kryesore kundër sundimit të ligjit. Kur shkeljet në lidhje me zgjatjen e procedurave gjyqësore bëhen të shpeshta dhe nuk janë raste të izoluara, atëherë akumulimi i këtyre shkeljeve përbën një praktikë e cila nuk është në përputhje me KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së: *Bottazzi kundër Italisë*, nr. 34884/97, Aktgjykim i 28 korrikut 1999, paragrafi 22).

72. Arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse të secilit rast (shih rastin e GJEDNJ-së: *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000, paragrafi 43). Vlerësimi për arsyeshmërinë e zgjatjes së procedurave gjyqësore duhet të bëhet mbi bazën e karakteristikave të një rasti, për shembull, në çështjen e ndarjes së trashëgimisë ndërmjet pasardhësve të një personi të vdekur, e cila zgjati më shumë se 22 vjet (shih rastin e GJEDNJ-së: *Omdahl kundër Norvegjisë*, nr. 46371/18, Aktgjykim i 6 shtatorit 2021, paragrafët 471, 54-55). Arsyeshmëria e zgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: kompleksiteti i rastit, sjellja e palës, sjellja e autoriteteve shtetërore dhe rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih rastet e GJEDNJ-së: *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006, paragrafi 128; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019, paragrafi 209).

*Kriteret e vlerësimit të arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës*

*Kompleksiteti i rastit*

73. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, kompleksiteti i rastit mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen (shih rastet e GJEDNJ-së: *Papachelas kundër Greqisë*, nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, nr. 12539/86, Aktgjykim i 27 tetorit 1994, paragrafi 55; *H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 9580/81, Aktgjykim i 8 korrikut 1987, paragrafi 72; *Humen kundër Polonisë*, nr. 26614/95, Aktgjykim i 15 tetorit 1999, paragrafi 63; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 210).

74. Edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendas mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih rastin e GJEDNJ-së: *Famullia Katolike Greke e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 150).

*Sjellja e palës*

75. Sipas GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së nuk kërkon nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore, e as nuk mund të fajësohet për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës (shih rastet e GJEDNJ-së: *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 68; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 211).

76. Nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë dhe të mos përdorë taktika për ta shtyrë në favor të tij procedurën (shih rastin e GJEDNJ-së: *Union Alemntaria Sanders S.A kundër Spanjës*, nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'i mvishet autoriteteve shtetërore, dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih rastin e GJEDNJ-së: *Wiesinger kundër Austrisë*, nr. 11796/85, Aktgjykim i 30 tetorit 1991, paragrafi 57). Vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastin e GJEDNJ-së: *Humen kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 66).

77. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës: mungesa e vullnetit të palës për të dorëzuar shkresat mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës para gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih rastet e GJEDNJ-së: *Vernillo kundër Francës*, nr. 11889/85, Aktgjykim i 20 shkurtit 1991, paragrafi 34; *Konig kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 103; *Pizzetti kundër Italisë*, nr. 12444/86, Aktgjykim i 26 shkurtit 1993, paragrafi 18; *Beaumartin kundër Francës*, nr. 15287/89, Aktgjykim i 24 nëntorit 1994, paragrafi 33; dhe *Keaney kundër Irlandës*, nr. 72060/17, Aktgjykim i 30 prillit 2020, paragrafi 95).

*Sjellja e autoriteteve shtetërore*

78. Shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet: jo vetëm për sistemin gjyqësor, por për të gjitha institucionet publike (shih rastin e GJEDNJ-së: *Martins Moreira kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 60). Gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor, Gjykata duhet të vlerësojë procedurën në tërësi: megjithëqë shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë (shih rastin e GJEDNJ-së: *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 211).

79. Shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmang përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore, sepse është detyrë e shtetit që ta organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të përshtatshme (shih rastin e GJEDNJ-së: *Lechner dhe Hess kundër Austrisë*, nr. 9316/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 58). Mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për tejzgjatjen e procedurave (shih rastin e GJEDNJ-së: *Probstmeier kundër Gjermanisë*, nr. 20950/92, Aktgjykim i 1 korrikut 1997, paragrafi 64). Vonesat e shkaktuara nga reformat që synojnë të përshpejtojnë zgjidhjen e rasteve po ashtu nuk mund të shërbejnë si arsyetim për tejzgjatje të procedurës, për shkak se është përgjegjësi dhe detyrë e shtetit ta organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë që të shmangë tejzgjatjen e procedurave në rastet e mbetura pa u zgjidhur (shih rastin e GJEDNJ-së: *Fisanotti kundër Italisë*, nr. 32305/96, Aktgjykim i 23 prillit 1998, paragrafi 22).

80. Gjykata, në praktikën e saj gjyqësore, ka theksuar se gjykatat e rregullta duhet të kenë parasysh obligimin kushtetues dhe ligjor që çështjet t'i finalizojnë brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që vonesat e tejzgjatura të mos shkaktojnë pasiguri te palët. Gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra. Në të kundërtën, besimi i publikut ndaj rendit juridik do të rrezikohej (shih rastin e Gjykatës: KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022, paragrafi 67).

*Rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest*

81. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve të cilat për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë:

a) Rastet që ndërlidhen me statusin civil (çështja e divorcit, vërtetimi i atësisë) (shih rastet e GJEDNJ-së: *Bock kundër Gjermanisë*, nr. 11118/84, Aktgjykim i 29 marsit 1989, paragrafi 49; dhe *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002, paragrafi 44).

b) Rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët (shih rastet e GJEDNJ-së: *Hokkanen kundër Finlandës*, nr. 19823/92, Aktgjykim i 23 shtatorit 1994, paragrafi 72; *Tsikakis kundër Gjermanisë*, nr. 1521/06, Aktgjykim i 10 shkurtit 2011, paragrafët 64-68; *Paulsen-Medalen dhe Svensson kundër Suedisë*, nr. 16817/90, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 39*; Q dhe R kundër Sllovenisë*, nr. 19938/20, Aktgjykim i 8 shkurtit 2022, paragrafi 80).

c) Rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; çështjet që lidhen me pensionin (shih rastet e GJEDNJ-së: *Frydlender kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 45; *Vocaturo kundër Italisë*, nr. 11891/85, Aktgjykim i 24 majit 1991, paragrafi 17; *Obermeier kundër Austrisë*, nr. 11761/85, Aktgjykim i 28 qershorit 1990, paragrafi 72; *Sartory kundër Francës*, nr. 40589/07, Aktgjykim i 24 shtatorit 2009, paragrafi 34; *Ruotolo kundër Italisë*, nr. 12460/86, Aktgjykim i 27 shkurtit 1992, paragrafi 117; *Borgese kundër Italisë*, nr. 12870/87, Aktgjykim i 26 shkurtit 1992, paragrafi 18).

d) Rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga "sëmundje të pashërueshme" dhe kanë "pritje të reduktuar të jetëgjatësisë" (shih rastet e GJEDNJ-së: *X kundër Francës*, nr. 18020/91, Aktgjykim i 31 marsit 1992, paragrafi 47; dhe *A dhe të tjerët kundër Danimarkës*, nr. 20826/92, Aktgjykim i 8 shkurtit 1996, paragrafët 78-81).

e) Rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë (shih rastin e GJEDNJ-së: *Caloc kundër Francës*, nr. 33951/96, Aktgjykim i 20 korrikut 2000, paragrafi 120).

f) Në rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit (shih rastin e GJEDNJ-së: *Oršuš dhe të tjerët kundër Kroacisë*, nr. 15766/03, Aktgjykim i 16 marsit 2010, paragrafi 109).

g) Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, për shembull rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore, apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih rastet e GJEDNJ-së: *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 213; *Omdahl kundër Norvegjisë*, nr. 46371/18, Aktgjykim i 22 prillit 2021, paragrafi 63-64).

### *B. Aplikimi i parimeve në rrethanat e rastit konkret*

*(i) Periudha që do të merret parasysh*

82. Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ka vlerësuar se përllogaritja e shtrirjes në kohë të procedurave fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palëve për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih rastet e GJEDNJ-së: *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 64; dhe *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 50). Ky proces konsiderohet i përfunduar me nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë kompetente gjyqësore e fundit (shih rastin e GJEDNJ-së: *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50).

83. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës më 6 prill 1994 inicioi kontest civil pranë Gjykatës Komunale me kërkesë që të vërtetohet pronësia e tij mbi një paluajtshmëri. Padia e parashtruesit të kërkesës ishte objekt shqyrtimi në Gjykatën Komunale deri më 6 prill 2012, kur lënda kaloi në Dhomën e Posaçme, pasi Gjykata Komunale u shpall jokompetente për ta trajtuar lëndën në pikëpamje lëndore.

84. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se rasti i parashtruesit të kërkesës, përkitazi me çështjen që është objekt i shqyrtimit para Gjykatës, ka filluar më 6 prill 1994, ka vazhduar të shqyrtohet edhe pas 15 qershori 2008, kur Kushtetuta ka hyrë në fuqi, dhe përfshin periudhën deri më 8 janar 2026, kur parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë, gjithsej 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet, 6 (gjashtë) muaj dhe 24 (njëzet e katër) ditë, dhe ende pret të zgjidhet në merita, e cila është periudha që do të merret parasysh nga Gjykata. Gjykata vëren se periudha prej 3 (tre) vjet, 9 (nëntë) muaj dhe 22 (njëzet e dy ditë) ditë i atribuohet Gjykatës Komunale, derisa periudha prej 13 (trembëdhjetë) vjet, 9 (nëntë) muaj dhe 2 (dy) ditë i atribuohet Dhomës së Posaçme. Rrjedhimisht, Gjykata do të fokusohet në vlerësimin e tejzgjatjes të procedurës në Dhomën e Posaçme.

*(ii) Parimet relevante*

85. Gjykata, para së gjithash, thekson se, sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar të GJEDNJ-së, e cila është reflektuar edhe në praktikën e deritanishme gjyqësore të Gjykatës, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, përkatësisht kriteret që i referohen: (a) ndërlikueshmërisë së rastit, (b) sjelljes së palëve në procedurë, (c) sjelljes së gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike, si dhe (d) rëndësisë së asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest (shih rastet e GJEDNJ-së: *Mikulić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 38; *Frydlender kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 41; dhe *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006, paragrafi 128).

*(iii) Analiza e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës*

86. Për të konstatuar nëse kohëzgjatja e procedurës ka qenë e arsyeshme, Gjykata duhet të marrë parasysh faktorët si në vijim: (a) ndërlikueshmërinë e rastit, (b) sjelljen e parashtruesit të kërkesës, (c) sjelljen e autoriteteve relevante gjyqësore, si dhe (d) rëndësinë e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin e kërkesës në kontest.

*(iv) Ndërlikueshmëria e rastit*

87. Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përmes së cilës është theksuar se ndërlikueshmëria e rastit mund të ndërlidhet me çështje të faktit dhe të ligjit, por gjithashtu mund të ndërlidhet edhe me përfshirjen e disa palëve në procedurë apo me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta (shih rastet e GJEDNJ-së: *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 55; *H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 72; dhe *Humen kundër Polonisë*, nr. 26614/95, Aktgjykim i 15 tetorit 1999, paragrafi 63). Po ashtu, sipas GJEDNJ-së, në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendas mund ta vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe mund të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih rastin e GJEDNJ-së: *Famullia Katolike Greke e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 150).

88. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se objekt i shqyrtimit në këtë kontest është vërtetimi i pronësisë mbi një paluajtshmëri, përkitazi me të cilën parashtruesi i

kërkesës dhe paditësit e tjerë pretendojnë se janë pronarë. Gjykata vëren se deri në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë ndërruar jetë 2 (dy) paditës, trashëgimtarët e të cilëve kanë marrë cilësinë e paditësve, dhe se në këtë rast, duke përfshirë këtu dhe parashtruesin e kërkesës, janë gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) paditës dhe një (1) palë e paditur, respektivisht KB "Rugova". Gjykata, nga përgjigjet e pranuara nga Dhoma e Posaçme, nuk vëren se kjo e fundit ka dhënë ndonjë arsye specifike që ndërlidhet me ndërlikueshmërinë e rastit, e cila mund të ketë ndikuar në tejzgjatjen e procedurës, përfshirë këtu natyrën e rastit që mund të kërkojë vlerësimin e çështjeve faktike dhe ligjore, vlerësimin e provave, nivelin e një kompleksiteti të caktuar faktesh apo provat. Megjithatë, Gjykata rikujton se edhe nëse do të të ekzistonin të njëjtat, nuk e justifikon një procedurë me kohëzgjatje të tillë.

*(v) Sjellja e parashtruesit të kërkesës*

89. Gjykata thekson se parashtruesit e kërkesave në parim kanë të drejtë të ndjekin të gjithë hapat proceduralë të vënë në dispozicion nga ligjet në fuqi. Megjithatë, parashtruesit e kërkesave duhet të kenë parasysh gjithashtu pasojat në rast se mjetet ligjore të shfrytëzuara mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e shqyrtimit të rastit të tyre. Gjykata konsideron se sjellja e parashtruesve të kërkesave përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet gjykatave dhe që duhet marrë parasysh në konstatimin nëse procedurat vazhduan më gjatë sesa afati i arsyeshëm kohor, i garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së: *Eckle kundër Gjermanisë*, nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 82).

90. Gjykata vëren se gjatë periudhës sa lënda ishte në shqyrtim në Gjykatën Komunale, avokati i paditësve, përfshirë këtu parashtruesin e kërkesës, më 29 gusht 2009 kishte dorëzuar parashtresë, përmes së cilës kishte kërkuar që të caktohet seanca kryesore në këtë çështje juridike. Po ashtu, më 29 nëntor 2009 kishte dorëzuar parashtresën për vazhdim të procedurës së ndërprerë si pasojë e vdekjes së 2 (dy) nga paditësit dhe përmes së njëjtës e kishte njoftuar gjykatën lidhur trashëgimtarët, duke plotësuar kështu kërkesën në pikëpamje subjektive për trashëgimtarët ligjorë të paditësve të ndjerë.

91. Po ashtu, 2 (dy) seanca të caktuara nuk ishin mbajtur si rrjedhojë e kërkesës së avokatit të paditësve, përfshirë këtu parashtruesin e kërkesës, kurse 1 (një) seancë pasi ekspertët e gjeodezisë nuk i dorëzuan Gjykatës Komunale ekspertizën lidhur me daljen në vend më 21 prill 2011, dhe në këtë kontekst, ishte bërë e pamundur për avokatin e paditësve, përfshirë këtu edhe parashtruesin e kërkesës, që të bëjë precizimin e kërkesëpadisë. Andaj, me propozim të të autorizuarve të ndërgjyqësve, seanca ishte shtyrë.

92. Në ndërlidhje me sjelljen e parashtruesit të kërkesës në procedurën pranë Dhomës së Posaçme, Gjykata vëren se tre (3) nga paditësit kishin paraqitur kërkesa të veçanta secili prej tyre për blerje të aseteve-paluajtshmërive *"në formë Rregullores për shitjen e aseteve të caktuara të ndërmarrjeve shoqërore me negocim direkt"*.

93. Gjykata po ashtu vëren se më 16 maj 2014, Dhoma e Posaçme ka lëshuar urdhër dhe ka kërkuar nga avokati i paditësve, përfshirë këtu edhe parashtruesin e kërkesës, të deklarohet në lidhje me përgjigjen në kërkesëpadi të paraqitur nga pala e paditur, për çka nuk ishte pranuar përgjigje.

94. Përkitazi me dy rrethanat e lartpërmendura, Gjykata vëren se Dhoma e Posaçme në përgjigjet e saj drejtuar Gjykatës theksoi se "[...]*është se kjo lënde ka qenë te gjyqtari tjetër, por mos përgjigja e avokatit të paditësve, në urdhër të gjykatës për tu deklaruar në parashtresën e përgjigjes në padi nga AKP-ja, të cilin urdhër e kishte pranuar*

*avokati me 20 04 2014 ndoshta ka ndikuar që me rastin të mos veprohet, pasi si prioritet të rasteve kanë qenë kërkesat e punëtorëve të natyrave të ndryshme, ndaj NSH-ve. Mirëpo nga parashtresa e AKP-së, dt 28.01.2025 që me të është bashkëngjitur prova e dorëzuar kërkesa e palës [A.SH] për negocim direkt, e ushtruar në AKP në vitin 2020, ndoshta ka ndikuar që palët paditëse të presin përgjigjen e AKP-së për negocim. Këtë kërkesë pala paditëse e ka heshtur para gjykatës me parashtresën 23.01.2026. Pra në rastin konkret, avokati i paditësve nga momenti kur e ka pranuar Urdhrin për përgjigje në parashtresë të AKP-së, dt. 20.04.2014, dhe mos dorëzim të asnjë parashtrese, deri në momentin kur e ka pranuar urdhrin tjetër të dt. 29.12.2025, kur nga gjykata ju kanë kërkuar plotësimet e parashtresave me prova, mund të ketë ndikuar që kjo çështje të shqyrtohet më ngadalë […]".*

95. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se është detyrë e Dhomës së Posaçme të mbikëqyrë mbarëvajtjen e procedurës dhe se e njëjta ka në dispozicion mekanizmat për të ndërmarrë veprime, në rast se palët nuk i përgjigjen urdhrave të së njëjtës, në mënyrë që të evitohen vonesat në procedurë. Prandaj, duke u bazuar në veprimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se veprimet e parashtruesit të kërkesës nuk mund të kenë ndikuar në vonesën e gjykatave të rregullta, respektivisht në shqyrtimin e rastit të tij, dhe as nuk rezulton të jetë ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të shtyrjes së procedurës; dhe si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e tillë e procedurës lidhur me rastin e parashtruesit nuk mund t'i atribuohet atij.

*(vi) Sjellja e autoriteteve relevante gjyqësore*

96. Gjykata fillimisht vë në dukje qëndrimin parimor të GJEDNJ-së se paragrafi 1 i nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së kërkon nga shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit në fjalë, duke përfshirë edhe detyrimin për të shqyrtuar çështjet brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së: *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12, Aktgjykim i 1 prillit 2014, paragrafi 91; *Abdoella kundër Holandës*, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992, paragrafi 24; dhe *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2010.

97. Në këtë kontekst, GJEDNJ-ja kishte theksuar se nuk mund të merret në konsideratë arsyetimi i gjykatave për mbingarkesën me lëndë të pazgjidhura (shih rastet e GJEDNJ-së: *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, cituar më lart, paragrafët 70-71 dhe 94-96; dhe *Vocaturo kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 17).

98. Gjykata rikujton se më lart theksoi se padia për vërtetim të pronësisë nga ana e parashtruesit të kërkesës dhe paditësve të tjerë ishte paraqitur më 6 prill 1994 në Gjykatën Komunale dhe ka vazhduar të shqyrtohet edhe pas 15 qershorit 2008, kur Kushtetuta ka hyrë në fuqi. Gjykata po ashtu specifikoi se periudha prej 3 (tre) vjet, 9 (nëntë) muaj dhe 22 (njëzet e dy ditë) ditë i atribuohet Gjykatës Komunale, derisa periudha prej 13 (trembëdhjetë) vjet, 9 (nëntë) muaj dhe 2 (dy) ditë i atribuohet Dhomës së Posaçme. Gjykata në vijim do të elaborojë historikun e sjelljes së organeve gjyqësore, duke filluar me Gjykatën Komunale dhe për të vazhduar më tutje me fokus në veprimet procedurale të Dhomës së Posaçme.

99. Gjykata vëren nga shkresat e lëndës se në Gjykatën Komunale është mbajtur seanca e 23 janarit, ku është marrë aktvendim procedural dhe nga Arkivi i Komunës së Gjakovës është kërkuar procesverbali [nr.273] i 18 shkurtit 1949 i Këshillit Popullor në Rugovë dhe pas seancës të mbajtur me 6 nëntor 2009, ku gjykata ishte njoftuar se 2 (dy) paditës kanë ndërruar jetë, ishte marrë aktvendim përmes së cilit u ndërpre procedura në këtë rast derisa u përcaktua se procedura mund të vazhdojë pasi të përfundohet procedura e

trashëgimisë me iniciativën e ndonjërit nga palët në kontest apo trashëgimtarëve eventualë. Tutje, më 20 nëntor 2009, avokati i paditësve, përfshirë këtu edhe parashtruesin e kërkesës, kishte dorëzuar parashtresën për vazhdim të procedurës dhe përmes së njëjtës ka njoftuar gjykatën lidhur trashëgimtarët, duke plotësuar kështu kërkesën në pikëpamje subjektive për trashëgimtarët ligjorë të paditësve të ndjerë. Gjatë kohës sa lënda ishte në shqyrtim në Gjykatë Komunale, më 21 prill 2011, është mbajtur seanca gjyqësore me nxjerrje të provës për identifikim të pronës lëndore në vendshikim, në prezencë të ekspertëve të gjeodezisë.

100. Tutje, më 11 maj 2011, seanca e caktuar nuk u mbajt, pasi ekspertët e gjeodezisë nuk i dorëzuan Gjykatës Komunale ekspertizën lidhur me daljen në vend më 21 prill 2011, përkundër faktit se kanë qenë të obliguar të dorëzojnë të njëjtën në afatin brenda shtatë (7) ditësh. Në këtë kontekst, u bë e pamundur për avokatin e paditësve, përfshirë parashtruesin e kërkesës, që të bëjë precizimin e kërkesëpadisë. Andaj, me propozim të autorizuarve të ndërgjyqësve, seanca ishte shtyrë për 21 korrik 2011. Raporti me shkrim dhe skicë të matjeve lidhur me ngastrat kadastrale ishte hartuar më 8 korrik 2011. Ndërkaq, seancat e 21 korrikut 2011 dhe ajo 8 dhjetorit 2011 nuk ishin mbajtur me kërkesë të avokatit të paditësve, përfshirë këtu edhe parashtruesin e kërkesës.

101. Gjykata rikujton se më 11 janar 2012, sipas kërkesës së përfaqësuesit të AKP-së, Zyra Regjionale në Pejë, është marrë aktvendim procedural, me të cilin Gjykata Komunale u shpall jokompetente në pikëpamje lëndore dhe konstatoi se pasi ky aktvendim të marrë formën e prerë, shkresat e lëndës do t'i dërgohen Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, si gjykatë me kompetencë ekskluzive për procedim të mëtejmë. Gjykata vëren se periudha prej 3 (tre) vjet, 9 (nëntë) muaj dhe 22 (njëzet e dy) ditë i atribuohet Gjykatës Komunale, meqë lënda e parashtruesit të kërkesës i kaloi Dhomës së Posaçme më 6 prill 2012.

102. Përkitazi me këtë lëndë, nga Dhoma e Posaçme, urdhri drejtuar të paditurit KB Rugova, të përfaqësuar nga AKP, që të deklarohet në kërkesëpadi, u lëshua më 15 prill 2013, respektivisht 1 (një) vit e 9 (nëntë) ditë nga pranimi i lëndës. Pala e paditur u përgjigj në kërkesë të Dhomës së Posaçme më 13 maj 2013, ndërkaq më 16 maj 2014, respektivisht 1 (një) vit e 3 (tre) ditë pas pranimit të kësaj përgjigjeje, Dhoma e Posaçme lëshoi urdhër dhe kërkoi nga avokati i paditësve, përfshirë këtu edhe parashtruesin e kërkesës, që të deklarohet në parashtresën e lartcekur të palës së paditur. Gjykata vëren se më 20 maj 2014, avokati i paditësve ka pranuar urdhrin dhe parashtresën e AKP-së, por nuk është deklaruar përkitazi me të.

103. Gjykata tutje rikujton se më 29 dhjetor 2025, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka lëshuar urdhër, për paditësit dhe të padituri, me qëllim të përgatitjes së seancës dëgjimore publike. Paditësve u është kërkuar që në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh të (i) plotësojnë padinë e tyre, duke saktësuar se kush janë palë paditëse dhe të dorëzojnë dëshmi të vdekjes/aktvendimin për shqyrtim të trashëgimisë; (ii) të dorëzojnë prova lidhur me vërtetim e fakteve, të tregojnë bazën juridike në kërkesë pronësore dhe të precizojnë kërkesëpadinë; si dhe (iii) të plotësojnë ekspertizën gjeodezike, pasi është e mangët. Po ashtu, AKP-së i është kërkuar që në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh të deklarohet në kërkesëpadi të paditësve, pasi përfaqësuesi i tyre në seancë gjyqësore ishte deklaruar vetëm lidhur me kompetencën lëndore.

104. Përkitazi me veprimin procedural të lartpërmendur, Gjykata sjell në vëmendje se Dhoma e Posaçme të njëjtin e ndërmori 11 (njëmbëdhjetë) vjet, 7 (shtatë) muaj e 13 (trembëdhjetë) ditë pas urdhrit të lëshuar në drejtim të avokatit të paditësve, përfshirë këtu edhe parashtruesin e kërkesës, që të deklarohet në parashtresën e palës së paditur.

105. Siç është sqaruar edhe nga Gjykata, me qëllim të pasqyrimit të plotë të fakteve, Gjykata i është drejtuar dy (2) herë me kërkesë për informata shtesë Dhomës së Posaçme, ndërkaq nga përgjigjet Gjykata vëren se theksohet si në vijim: *"[...], është se kjo lënde ka qenë te gjyqtari tjetër, por mos përgjigja e avokatit të paditësve, në urdhër të gjykatës për tu deklaruar në parashtresën e përgjigjes në padi nga AKP-ja, të cilin urdhër e kishte pranuar avokati me 20 04 2014 ndoshta ka ndikuar që me rastin të mos veprohet, pasi si prioritet të rasteve kanë qenë kërkesat e punëtorëve të natyrave të ndryshme, ndaj NSH-ve. Mirëpo nga parashtresa e AKP-së, dt 28.01.2025 që me të është bashkëngjitur prova e dorëzuar kërkesa e palës [A.SH.] për negocim direkt, e ushtruar në AKP në vitin 2020, ndoshta ka ndikuar që palët paditëse të presin përgjigjen e AKP-së për negocim. Këtë kërkesë pala paditëse e ka heshtur para gjykatës me parashtresën 23.01.2026.Pra në rastin konkret, avokati i paditësve nga momenti kur e ka pranuar Urdhrin për përgjigje në parashtresë të AKP-së, dt. 20.04.2014, dhe mos dorëzim të asnjë parashtrese, deri në momentin kur e ka pranuar urdhrin tjetër të dt. 29.12.2025, kur nga gjykata ju kanë kërkuar plotësimet e parashtresave me prova, mund të ketë ndikuar që kjo çështje të shqyrtohet më ngadalë, pastaj prioritetet e shqyrtimit të rasteve, pastaj përbërja e kolegjeve të përzir me gjyqtar të EULEX, dhe procedurat e përkthimeve të parashtresave dhe shkresave në gjuhën angleze të ketë pasur ndikim".*

106. Gjykata po ashtu vëren se Dhoma e Posaçme në përgjigjen e saj nuk mëton se arsyet e mostrajtimit të këtij rasti mund të ndërlidhen me kompleksitete ligjore apo faktike, dhe rrethanat e mësipërme, të cilat përmenden nga ana e Dhomës së Posaçme, ndërlidhen me çështje procedurale, për adresimin e së cilave Dhoma e Posaçme zotëron mekanizma për t'i adresuar dhe të njëjtat nuk mund t'i mvishen parashtruesit të kërkesës.

107. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se çështja e parashtruesit të kërkesës është në procedurë gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme nga data e pranimit të lëndës te kjo e fundit e deri në parashtrimin e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së tejzgjatjes së procedurës në periudhë kohore prej 13 (trembëdhjetë) vjet, 9 (nëntë) muaj e 2 (dy) ditë.

108. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se lëndët nuk mund të mbeten pafundësisht të pazgjidhura në një instancë gjyqësore pranë gjykatave të rregullta dhe se periudha prej 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet, 6 (gjashtë) muaj e 24 (njëzet e katër) ditë në pritje të zgjidhjes së lëndës civile në fjalë u atribuohet organeve gjyqësore, respektivisht gjykatave të rregullta, me theks në rrethanat e rastit konkret, Dhomës së Posaçme.

109. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se shkaku kryesor i kohëzgjatjes së tepruar të procedurës në këtë rast është veprimi i ngadaltë dhe joefikas i Dhomës së Posaçme, e cila në periudhë prej mbi 13 (trembëdhjete) vjet nuk ka ndërmarrë masa adekuate për ta zgjidhur çështjen brenda një afati të arsyeshëm, duke bërë që shteti të mos përmbushë detyrimin e tij për sigurimin e të drejtës efektive për gjykim brenda një afati të arsyeshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

*(vii) Rëndësia e asaj çfarë rrezikon parashtruesi i kërkesës në kontest*

110. Lidhur me kriterin e asaj çfarë rrezikon parashtruesi i kërkesës në kontest, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila sqaron se një kategori e rasteve kërkon zgjidhje të veçantë ekspeditive. Sipas kësaj praktike, shembuj që kërkojnë kujdes të veçantë dhe zgjidhje me prioritet janë rastet që ndërlidhen me statusin dhe kapacitetin civil, rastet rreth kujdestarisë së fëmijëve dhe marrëdhënies prind-fëmijë, kontestet nga marrëdhënia e punës, rastet e parashtruesve që vuajnë nga *"sëmundje të pashërueshme"* dhe kanë *"pritje të reduktuar të jetëgjatësisë"*, si dhe rastet rreth të

drejtës për arsim (shih rastin e GJEDNJ-së: *Frydlender kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 45).

111. Rrjedhimisht, Gjykata, bazuar në praktikën e konsoliduar gjyqësore të GJEDNJ-së, thekson se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës nuk është çështje që kërkon *"kujdes të posaçëm"* siç janë shembujt e lartcekur të vlerësuar nga GJEDNJ-ja si kategori e çështjeve që kërkojnë zgjidhje me prioritet. Megjithatë, Gjykata thekson se nuk mund të konsiderohet e arsyeshme një periudhë kaq e gjatë për zgjidhjen e një rasti të tillë, pavarësisht natyrës së rastit. Gjykata konsideron se tejzgjatja e trajtimit të çështjes në fjalë është e papranueshme në rrethanat e rastit konkret dhe, si e tillë, është në kundërshtim të plotë me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, ashtu siç garantohet me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

**(II) Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës**

112. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se si pasojë zvarritjes së tejzgjatur të procedurës gjyqësore i është cenuar edhe e drejta e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës), meqë thekson se edhe pse nuk ka konfiskim formal, mosmarrja e një vendimi përfundimtar për mbi 30 (tridhjetë) vjet përbën ndërhyrje indirekte në gëzimin paqësor të pronës, cenim të sigurisë juridike dhe kufizim faktik të disponimit me pronën. Tutje, specifikon se *"Pronësia nuk është vetëm titull formal, por përfshin të drejtën për ta përdorur, disponuar dhe zhvilluar pronën. Pa një vendim gjyqësor, këto të drejta mbeten pezull. Në rastin konkret, vonesa nuk ndjek ndonjë qëllim legjitim publik. Ajo është rezultat i mosveprimit institucional. Për rrjedhojë, ndërhyrja është joproporcionale dhe në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së"*.

113. Megjithatë, Gjykata rikujton se objekt i kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës është pikërisht vërtetimi i pronësisë së pronës kontestuese.

114. Po ashtu, Gjykata rikujton se, duke qenë se Gjykata tashmë ka konstatuar se në rastin e parashtruesit së kërkesës ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, pikërisht për shkak të kohëzgjatjes së procedurës, Gjykata nuk do të vijojë me shqyrtimin e këtij pretendimi.

**Përkitazi me kërkesën për kompensim**

115. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar edhe që Republika e Kosovës t'ia kompensojë shumën prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro *"[...]për shkak të dhimbjeve shpirtërore si pasoj e shkeljeve të drejtave elementare njerëzore [...]"*.

116. Lidhur me këtë, Gjykata ka ripërsëritur se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih rastet e Gjykatës KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha*, Aktgjykim, i 12 shkurtit 2025, paragrafi 68, KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana*, Aktgjykim, i 18 korrikut 2022, paragrafi 115; KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović*, cituar më lart, paragrafi 84; e KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, Aktgjykim, i 22 dhjetorit 2022, paragrafi 104; dhe KI43/26, parashtrues *Genc Hamza*, Aktgjykim, i 25 qershorit 2026, paragrafi 65).

117. Gjykata në vazhdimësi ka theksuar dhe në rrethanat e rastit konkret sërish ripërsëritë se Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë të përcaktuar me Kushtetutë dhe me Ligj për të akorduar kompensim për parashtruesit e kërkesave në rastet e konstatimit të

shkeljes së drejtave dhe lirive të tyre. Si rrjedhojë, Gjykata në mungesë të një kompetence apo autorizimi, kërkesat e parashtruesve të kërkesave për kompensim nuk i shqyrton dhe vlerëson në procedurat para saj. Gjykata në vendimmarrjen e saj vetëm ka nënvizuar se individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jo-material pranë gjykatave të rregullta (shih, rastet e Gjykatës KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha*, cituar më lart, paragrafi 69; dhe KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović*, cituar më lart, paragrafi 85).

**Përfundime**

118. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se: (i) megjithëse rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kontest pronësor, nuk rezulton të jetë i një natyre aq të ndërlikuar saqë do të mund të justifikonte që procedura gjyqësore për zgjidhjen e lëndës përkatëse të mos përfundojë as pas kaq shumë kohe në një instancë gjyqësore; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka kontribuar në tejzgjatjen e procedurës përmes veprimeve të tij; ndërsa (iii) gjykatat e rregullta në një periudhë që përfshinë 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet, 6 (gjashtë) muaj dhe 24 (njëzet e katër) ditë, nuk kanë vendosur ende lidhur me çështjen e parashtruesit të kërkesës, nga të cilat periudha prej 3 (tre) vjet, 9 (nëntë) muaj dhe 22 (njëzet e dy ditë) ditë i atribuohet Gjykatës Komunale, derisa periudha prej 13 (trembëdhjetë) vjet, 9 (nëntë) muaj dhe 2 (dy) ditë i atribuohet Dhomës së Posaçme.

119. Thënë këtë, Gjykata konstaton se, në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, ka shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

120. Gjykata, bazuar në konstatimin e mësipërm për shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, thekson se, pasi të plotësohen kushtet ligjore për vazhdimin e procedurës, meqë aktualisht është e ndërprerë përmes Aktvendimit të 10 prillit 2026, të marrë pas parashtrimit të kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë së tejzgjatjes së procedurës, Dhoma e Posaçme duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm proceduralë për procedimin e mëtejmë të lëndës me dinamikë dhe prioritet, në mënyrë që t'i japë epilog çështjes juridike të parashtruesit të kërkesës brenda një afati sa më të afërt kohor, konform gjetjeve të këtij Aktgjykimi.

121. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se përfundimi i lartcekur ekskluzivisht ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurave sa i përket shqyrtimit të rastit të parashtruesit të kërkesës dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit të tij para gjykatave të rregullta.

**PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit, si dhe me rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 nëntor 2026, njëzëri:

**VENDOS**

I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor;

III. TË URDHËROJË Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme që jo më larg se 24 maj 2027 ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese;

IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;

V. TË KONSTATOJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

| **Gjyqtari raportues** | **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese** |
|---|---|
| Radomir Laban | Nexhmi Rexhepi |